Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e

qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula _____

Shtojca 8

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

Loti 1- Artikuj ushqimore qe prishen

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;
- c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 8 të ketyre DT (**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit**).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 1. Kopje të deklaratave të **xhiros vjetore** ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në vitin **2019**, vlera të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të këtij Loti**.
- 2. Kopje e çertifikuar të **bilancit të vitit 2019**, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore.
- 3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2020 pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatorëve duhet të ketë vërtetimin e shlyerjes së taksës vendore 2020 për secilin operator).*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar **është jo më pak se 2 200 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Per këtë pike Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtme:

- a-** Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b-** Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë liçence nga Qendra Kombëtare e Liçencimit për produktet me origjinë shtazore Licencë të **kategorisë II.1.A.1** – “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me

shumicë e ushqimeve për njerëz”.(Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

2.3.3 Operatori duhet të ketë në pronësi (vërtetuar me akti i pronësisë kopje e noterizuar) ose me qera kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara dhe dokumentit të pronësisë në emër të qeradhënësit ambiente të përshtatshme për prodhim dhe magazinim të **artikullit bukë** të pajisur me Leje higjeno-sanitare të lëshuar nga inspektoriat shëndetësor.

2.3.2 Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) për **artikullin bukë**.

2.3.4 Operatori ekonomik të paraqesë raportin e analizës kryer nga laboratorë të licensuar nga organet kompetente (AKU) të lëshuar jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë nga hapja e ofertave për **artikullin buke** (1kg).

2.3.5 Operatori duhet të ketë në pronësi (vërtetuar me akti i pronësisë kopje e noterizuar) ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara të ambienteve të përshtatshme për tregtimin dhe magazinimin e **produkteve të mishit** të pajisur me leje higjeno-sanitare të lëshuar nga inspektoriat shëndetësor

2.3.6 Operatori duhet të ketë në pronësi (vërtetuar me akti i pronësisë kopje e noterizuar) ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara ambiente të përshtatshme për tregtimin dhe magazinimin e **produkteve të bulmetit** ku të ketë ambient frigoriferik të pajisur me leje higjeno-sanitare të lëshuar nga inspektoriat shëndetësor.

2.3.7 Operatori ekonomik të paraqesë liçence nga Qendra Kombëtare e Liçencimit për produktet **me origjinë shtazore**.

2.3.8 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratës përkatëse të noterizuar, mjete transporti të vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës për furnizimin e ushqimeve blegtorale, si me poshte:

2.3.8.1 Automjet te pershtatshem (frigoriferik ATV) per **artikujt bulmet dhe mish (1 cope)**. Per automjetet te paraqiten certifikatat e pronësisë, kontratat e dhurimit apo te qirase sipas rastit, si dhe dokumentacionin perkates: Certifikatat e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit dhe Siguracion te automjeteve ne dispozicion, leje per transport mallrash si dhe leja higjeno-sanitare te mjetit. (dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshmem ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi).

2.3.8.2 Operatori ekonomik duhet te disponoje automjet te pershtatshem per **transportin e bukes**. Per automjetin te paraqitet certifikatat e pronësisë, kontratat e dhurimit apo te qirase sipas rastit si dhe dokumentacionin perkates: Certificate e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit dhe siguracionin e mjetit ne dispozicion, leje per transport mallrash si dhe leja higjeno-sanitare te mjetit (dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshmem ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi).

2.3.9 Vetëdeklarim ku te deklaroje se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarres duhet të disponojë:

Çertifikate ISO 9001-2015,

Certifikate ISO 22000-2018

Certifikatat të jene të vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës.

Shenim: *Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. (Sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

Loti 2- Artikuj ushqimore që nuk prishen

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);*
- b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;*
- c. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*
- d. *Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 8 të ketyre DT (**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit**).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Kopje të deklaratave të **xhiros vjetore** ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në vitin **2019**, vlera të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të këtij Loti**.
2. Kopje e certifikuar të **bilancit të vitit 2019**, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore.
3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2020 pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatorëve duhet të kete vërtetimin e shlyerjes së taksës vendore 2020 për secilin operator).*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se 380

000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

- c-** Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d-** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik te paraqesë licencen kategoria II.1.A.1- "Prodhim përpunim dhe shpërndarje me shumice e ushqimeve për njerëz" të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Licenca duhet të jetë në emër të tij pasi ajo (licensa) duhet t'i përkasë operatorit të interesuar te ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument për pronësi (vërtetuar me akti i pronësisë kopje e noterizuar) ose në përdorim kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara te ambienteve të përshtatshme për tregtimin dhe magazinimin e artikujve ushqimorë që nuk prishen, objekt prokurimi e pajisur me leje higjieno-sanitare lëshuar nga inspektoriat shëndetësor.

2.3.4 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose në përdorim kundrejt kontratës përkatëse të noterizuar, mjete transporti të vlefshme për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës për furnizimin e ushqimeve, te pajisur me dokumentacionin ligjor: certifikatat e pronësisë, kontratat e dhurimit apo te qirase sipas rastit si dhe dokumentacionin përkatës: certifikate e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit dhe siguracionin e mjetit ne dispozicion, leje per transport mallrash si dhe leja higjieno-sanitare te mjetit (dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshem ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi).

2.3.5 Vetëdeklarim ku te deklaroje se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te disponoje:

Çertifikate ISO 9001-2015,
Certifikate ISO 22000-2018

Certifikatat te jene te vlefshme per gjithe periudhen e realizimit te kontrates.

Shenim: Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues, ku te provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. (Sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Loti 1 – Artikuj ushqimore qe prishen

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Karakteristikat per mallin
1.	Mish viçi	Kg	800	Çertifikate veterinerë dhe e kontrolluar, i fresket e te mos jete me ngjyre te erret
2.	Mish pule	Kg	2640	Çertifikate veterinerë dhe e kontrolluar.
3.	Kofsha pule	Kg	500	Çertifikate veterinerë dhe e kontrolluar.
4.	Djath	Kg	2400	Te çertifikuar dhe te kontrolluar, te kete fortesi ne perberje, i bardhe, pa erë te keqe, i amballazhuar ne fuçi me shellire te fresket.
5.	Sallam	Kg	540	Te çertifikuar dhe te kontrolluar, leje higjeno – sanitare
6.	Kos	Liter	7000	Te çertifikuar dhe te kontrolluar dhe me flete analize.
7.	Qumesht	Liter	6600	Te çertifikuar dhe te kontrolluar me aciditet normal dhe me flete analize.
8.	Gjalp	Kg	200	Te çertifikuar dhe te kontrolluar, me kripe e densitet normal.
9.	Veze	Kokrra	10800	Te çertifikuar dhe te kontrolluara
10.	Perime	Kg	6000	Te fresketa dhe cilesia e pare
11.	Fruta	Kg	1800	Te fresketa dhe cilesia e pare
12.	Bukë gruri	Kg	8500	Cilesi e mire, e kontrolluar (nje cope buke = 1 kg), e bute, e prodhuar brenda dites.
13.	Patate	Kg	960	Cilesia e pare dhe te mos jene te demtuara.
14.	Trahana	Kg	200	Cilesi e mire dhe brenda dates se konsumimit.
15.	Reçel	Kg	400	Cilesia e pare, brenda dates se konsumimit.
16.	Limontoz	Cope	100	Cilesia e pare, te paketuara dhe brenda dates se konsumimit.
17.	Kanell	Cope	200	Cilesia e pare, te paketuara dhe brenda dates se konsumimit.
18.	Sodë buke	Cope	200	Cilesia e pare, te paketuara dhe brenda dates se konsumimit.
19.	Ereza	Cope	100	Cilesia e pare, te paketuara dhe brenda dates se konsumimit, ereza te stines.
20.	Uthull	Cope	100	Cilesia e pare, te paketuara dhe brenda dates se konsumimit.

Dokumentat Standarde të Tenderit

21.	Petë byreku	Cope	750	Cilesia e pare, te paketuara dhe brenda dates se konsumimit.
22.	Çaj mali	Kg	6	Cilesia e pare, i fresket, me arome dhe ngjyre te mire.
23.	Qofte	Cope	3000	Cilesia e pare, te fresketa, te paketuara.
24.	Buke misri	Cope	150	Cilesia e pare.
25.	Kadaif	Kg	20	Cilesia e pare,i paketuar.
26.	Mish gjeldeti	Kg	100	I fresket, cilesia e pare.
27.	Arra	Kg	15	Cilesia e pare.
28.	Mish i grire	Kg	400	Çertifikate veterinerë dhe e kontrolluar.
29.	Mish gici	Kg	200	Çertifikate veterinerë dhe e kontrolluar, i fresket e te mos jete me ngjyre te erret

Loti 2-Artikuj ushqimore qe nuk prishen

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Karakteristika per mallin
1.	Oriz	Kg	1000	Oriz cilesia e mire, forma ovale, te jete i bardhe, i paketuar ne qese.
2.	Makarona	Kg	1400	Cilesi e mire, te gjata dhe te shkurtra, te paketuara ne qese.
3.	Sheqer	Kg	1400	I bardhe, cilesia e pare, i paketuar me leter.
4.	Vaj gjelle	Liter	1800	Vaj vegjetal, cilesia e mire, i rafinuar.
5.	Vaj ulliri	Liter	400	Cilesor, me aciditet te ulet, me shishe qelqi.
6.	Fasule	Kg	200	E bardhe qe zien lehte dhe kokerr mesatare.
7.	Miell gruri	Kg	1100	Cilesia e pare, i bardhe, me rreze 0 dhe i paster, i paketuar me leter.
8.	Miell misri	Kg	200	Cilesia e pare, i paketuar
9.	Niseshte	Kg	250	Cilesia e pare dhe te jete e paster, e paketuar ne leter.
10.	Salce	Cope	500	Kanaçe 400 gr, e trashe, cilesia e pare.
11.	Kafe	Kg	110	E bluar mire, cilesia e pare, me ngjyre dhe arome te kendeshme, e paketuar me qese.
12.	Kripe	Kg	200	E jodizuar, e bardhe, e paster, e paketuar.
13.	Pije freskuese	Cope	2400	Cilesia e pare, te paketuara ne kanace dhe brenda dates se konsumimit.
14.	Leng limoni	Cope	100	Cilesia e pare, te paketuara dhe brenda dates se konsumimit.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**Sasia e mallit që kërkohet: Loti 1 – Artikuj ushqimorë që prishen**

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1.	Mish viçi	Kg	800
2.	Mish pule	Kg	2640
3.	Kofsha pule	Kg	500
4.	Djath	Kg	2400
5.	Sallam	Kg	540
6.	Kos	Liter	7000
7.	Qumesht	Liter	6600
8.	Gjalp	Kg	200
9.	Veze	Kokrra	10800
10.	Perime	Kg	6000
11.	Fruta	Kg	1800
12.	Bukë gruri	Kg	8500
13.	Patate	Kg	960
14.	Trahana	Kg	200
15.	Reçel	Kg	400
16.	Limontoz	Cope	100
17.	Kanell	Cope	200
18.	Sodë buke	Cope	200
19.	Ereza	Cope	100
20.	Uthull	Cope	100
21.	Petë byreku	Cope	750
22.	Çaj mali	Kg	6
23.	Qofte	Cope	3000
24.	Buke misri	Cope	150
25.	Kadaif	Kg	20
26.	Mish gjeldeti	Kg	100
27.	Arra	Kg	15
28.	Mish i grire	Kg	400
29.	Mish gici	Kg	200

Afatet e lëvrimit: 12 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuader.

Gjithashtu : *Per ushqimet që prishen furnizimi duhet të jetë i përditshëm gjatë gjithë periudhës kontraktore dhe të shoqëruara me flete analize perkatëse.*

Loti 2-Artikuj ushqimore qe nuk prishen

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1.	Oriz	Kg	1000
2.	Makarona	Kg	1400
3.	Sheqer	Kg	1400
4.	Vaj gjelle	Liter	1800
5.	Vaj ulliri	Liter	400
6.	Fasule	Kg	200
7.	Miell gruri	Kg	1100
8.	Miell misri	Kg	200
9.	Niseshte	Kg	250
10.	Salce	Cope	500
11.	Kafe	Kg	110
12.	Kripe	Kg	200
13.	Pije freskuese	Cope	2400
14.	Leng limoni	Cope	100

Afatet e lëvrimit: 12 muaj nga nenshkrimi i marrevshjes kuader.

Gjithashtu ***:Për ushqimet që nuk prishen furnizimi do të bëhet një herë në muaj.***

Të gjitha ushqimet duhet të kenë datën e skadimit dhe të shoqëruara me fletat e analizave përkatëse.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.

- 2.4 “Lëvrime” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të parashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.

- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikak, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.

- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
